



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

Nr. 345/2 prot.

Elbasan, me 17.03.2016

URDHËR

Nr. 14, datë 17.03.2016

**“PËR FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËN E ZHVILLIMIT TË
ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË UNIVERSITETIN
“ALEKSANDËR XHUVANI” ELBASAN”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 5/ 3 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë” nr.1459/1prot., datë 15.03.2016, si dhe në zbatim të Urdhrit të Ministrit Arsimit dhe Sportit nr.110 datë 15.03.2016 “Për fillimin e procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”,

Urdhëroj:

1. Fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, në datën 16.03.2016.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, të jetë më datë 20.04.2016.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Liman VAROSHI

